



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 43/2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Vlastimir Dimić dhe Hasan Shala, duke vendosur përkritazi për ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Ferizaj, paraqitur kundër Lëvizjes Vetëvendosja (LVV) dega në Ferizaj, për shkak të mbajtjes së tubimit publik para datës së caktuar për fushatë zgjedhore, për zgjedhjet e jashtëzakonshme lokale në Komunën e Ferizajt, në seancën e panelit të mbajtur me 17.04.2012, mori këtë:

V E N D I M

HIDHET poshtë ankesa si e palejuar.

A R S Y E T I M

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datën 13.04.2012 nga subjekti politik PDK, me të cilën pretendohet se LVV ka bërë shkelje *neneve 4.1, 4.2, 4.3 pika a dhe pika b të Rregullës Zgjedhore Nr. 13/2009 “Fushata e zgjedhjeve dhe njoftimi për ngjarjet politike”, sepse ka organizuar dhe mbajtur tubim publik me datë 09.04.2012, në ora 18:30, në shkollën fillore “Visar Dodani”, në fshatin Varosh. Parashtruesi i ankesës si provë i ka bashkangjitur ankesës Ftesën për mbajtjen e tubimit publik.*

Parashtruesi i ankesës propozon që të ndërmerren masat e parapara ligjore për rastin konkret.

KREU -VII- i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP)

Fushata e Zgjedhjeve dhe Njoftimi për Ngjarjet Politike

Neni 33 dhe 44 i LZP-së, Rregulla Zgjedhore nr. 11/2009, *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët* dhe Rregulla Zgjedhore Nr. 13/2009 *Fushata e zgjedhjeve dhe njoftimi për ngjarjet politike*, përcaktojnë aktivitetet e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, siç del nga të gjitha dispozita ligjore dhe Rregullat Zgjedhore të lartcekura, ndalojnë veprimet e subjekteve politike, mbështetësit e tyre ose kandidatët e tyre gjatë periudhës së fushatës zgjedhore.

PZAP-i nga shkresat e lëndës gjeti se:

ankesa është e palejuar

Siç shihet nga shkresat e lëndës, pretendimet e theksuara në ankesë, nuk janë bërë gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, andaj PZAP-i duke u bazuar në dispozitat e lartcekura ligjore konstatoi se nuk kemi të bëjmë me veprime të ndaluara, ngase me asnjë dispozitë ligjore të LZP-së, e as me Rregulla Zgjedhore nuk është paraparë ndonjë dispozitë ligjore që ndalon mbajtjen e tubimeve publike para datës së caktuar fushatë zgjedhore.

Në kuptim të dispozitës së nenit 115.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 43/2012 më datën 17.04.2012.

